



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 1084 Prot.

Tiranë, më 03/09/2024

URDHËR

Nr. 7, datë 03/09/2024

PËR

MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE PËR ZBATIMIN E URDHËRIT TË PËRBASHKËT NR. 112, DATË 05.07.2024 "PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025", NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për "Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Udhëzimit Nr. 12, datë 30.06.2023, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, Urdhrit të Përbashkët Nr. 112, datë 05.07.2024, "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2024-2025".

URDHËR O J:

Ngritjen e grupit të monitorimit të zhvillimit të konkurseve të pranimit për ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë "Master profesional", "Master i shkencave" dhe "Master i arteve" në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2024 - 2025, me përbërje si më poshtë:

- Prof. Arian Paço
- Prof. Asoc. Dorian Çene
- Znj. Suela Kromidha

1. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë "Master profesional", "Master i shkencave" dhe "Master i arteve" në UART, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore së UART brenda **datës 04 Tetor 2024**.
2. Më datë **04 tetor 2024** sekretaritë mësimore shpallin në vende të dukshme të njësive kryesore, listën emërore të kandidatëve që kanë aplikuar.
3. Konkursat e pranimit për të gjitha programet e studimit të ofruara nga fakultetet e UART do të zhvillohen nga data **07 - 10 tetor 2024**.
4. Më datë **11 tetor 2024**, sekretaritë mësimore të shpallin listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme të njësive kryesore, si dhe të publikojnë në faqen elektronike zyrtare të UART, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditura sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.
5. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues do të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse nga data **12 - 20 tetor 2024**.



6. Më **20 tetor 2024** njësitë kryesore të UART të shpallin në vende të dukshme dhe të publikojnë në faqen elektronike zyrtare, listën emërore të kandidatëve të regjistruar.

Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve me diplomë të huaj të shkollës së mesme, në programet e ciklit të parë të studimeve, si dhe të kandidatëve me diplomë të huaj të ciklit të parë për programet e studimit të ciklit të dytë të studimeve.

7. Afatet e aplikimit për kandidatët të cilët janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë janë të njëjta me ato të pikave 1; 2; 3; 4; 5 dhe 6 të këtij urdhri.
8. Kandidatët të cilët janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, në rast pranimi janë të detyruar të kryejnë njësimin e diplomës pranë QSHA-së brenda **datës 10 dhjetor** dhe ta dorëzojnë pranë sekretarive mësimore.
9. Brenda datës **15 dhjetor 2024** të dërgohen pranë QSHA-së, listat e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit.

Procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e ciklit të dytë të studimeve “Master profesional”, “Master i shkencave” dhe “Master i arteve”, në UART.

10. Kandidatët që kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve “*Master profesional*”, “*Master i shkencave*” dhe “*Master i arteve*” në UART, kanë të drejtën të aplikojnë pranë sekretarive mësimore të njësisë kryesore brenda datës **04 tetor 2024**.
11. Më datë **04 tetor 2024** sekretaritet mësimore shpallin në vende të dukshme të njësisë kryesore, listën emërore të kandidatëve që kanë aplikuar për transferim programi studimi dhe për program të dytë studimi.
12. Deri më datë **10 tetor 2024** të shqyrtohen nga komisionet të ngritura nga njësitë bazë të cilat kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kriterëve të tjera të shpallura nga njësia kryesore, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga përgjegjësi i njësisë kryesore përkatës në vende të dukshme.
13. Më datë **11 tetor 2024** sekretaritet mësimore të publikojnë listat me renditjen e kandidatëve për çdo program studimi. Në listën e publikuar, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.
14. Më datë **13 tetor 2024**, njësitë kryesore shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve në mjediset e tyre si dhe i publikojnë në faqen elektronike zyrtare (web) të UART.
15. Nga data **16 – 20 tetor 2024** kryhet regjistrimi pranë sekretarive mësimore të njësisë kryesore nga kandidati ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij.
16. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara pas vijës së kuqe deri më datë **27 tetor 2024**.
17. Deri më datë **21 Dhjetor 2024** të dërgohen pranë QSHA-së, listat e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit.



Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të pakicave rome dhe egjiptian, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të parë të studimeve.

18. Kandidatët nga Republika e Kosovës me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e pakicave rome dhe egjiptian, aplikojnë pranë sekretarive mësimore të njëjësive kryesore nga data **02 – 13 shtator 2024**.
19. Konkursët e pranimit për të gjitha programet e studimit të ofruara nga fakultetet e UART do të zhvillohen më datë **16 shtator 2024**.
20. Më datë **16 shtator 2024** të publikohen në mjedise të dukshme të fakulteteve, dhe faqen e tyre elektronike zyrtare listën paraprake të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
21. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues do të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse nga data **26 – 03 tetor 2024**.
22. Pas datës **04 tetor 2024**, sekretaritë mësimore të fakulteteve për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.
23. Brenda datës **10 tetor 2024**, përfundojnë të gjithë regjistrimin e kandidatëve fitues sipas dokumenteve të dorëzuar në momentin e aplikimit.
24. Administruesi i UART për sistemin e Portalit U-Albania të marri masat për ngarkimin e listave sipas afateve të përcaktuara më sipër në Portalin U-Albania.
25. Të afishohen në mjediset e secilit nga fakultetet të UART, Urdhrat/Vendimet mbi masat e marra për konkursët e pranimit të ciklin të dytë të studimeve me kohë të plotë Master, rregulloret dhe kriteret e konkurseve të pranimit, rregulloret dhe kriteret e transferimit të programit të studimit ose të konkurrimit në një program të dytë studimi, si dhe çdo procedurë tjetër të nevojshme për këtë proces.
26. Strukturat përgjegjëse të secilit fakultet të marrin masat e nevojshme për zhvillimin e konkurseve të pranimit si dhe ndjekjen me përgjegjësi të afateve të përcaktuara sipas etapave të zhvillimit të konkurseve dhe procedurave të regjistrimit të kandidatëve/studentëve deri në përcjelljen e tyre për numër matrikullimi në zbatim të kalendarit të Urdhrit të Përbashkët Nr. 112, datë 05.07.2024 dhe të këtij Urdhri.
27. Ngarkohen për zbatimin e urdhrit anëtarët e grupit të monitorimit, Dekanët e fakulteteve të UART, Administratori i UART, Përgjegjësit e Njësive Bazë, sekretaritë mësimore të fakulteteve, dhe çdo strukturë tjetër në ndihmë të këtij procesi.

Ky urdhër të shpallet në faqen elektronike zyrtare të Universitetit të Arteve.

REKTORI

Prof. Dr. Erand BAKALLI

